



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI ADMINISTRIMIT
VENDIM

Nr.7/1, datë 22.11.2018

MBI

**“MIRATIM PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË 2
STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA, PËR VITIN
AKADEMIK 2017-2018 ”**

Mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03. 2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”; kreun VI/2 të Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018” (i ndryshuar); urdhrin e Rectorit të Universitetit të Arteve nr. 2, datë 14.02.2018 mbi “Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018, në Universitetin e Arteve” shkresën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2921 prot, datë 19.03.2018 “Për vlerësimin me prioritet të studentëve të kategorive sociale në nevojë, si dhe studentëve të ekselencës që ndjekin studimet në vitin akademik 2017-2018”; si dhe në Relacionin e Grupi të Punës me nr. 340.prot, datë 03.05.2018 “Mbi materialin e përgatitur, nga grupi i punës, për studentët e ciklit të parë me kohë të plotë, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit dhe reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për studentët e ciklit të dytë me kohë të plotë, në Fakultetet e Universitetit të Arteve”; proces verbalit të Grupit të Punës me nr. 340/1 prot. datë 21.05.2018 dhe në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 28, datë 11.09.2018 mbi “Propozimin për miratim, për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të 2 studentëve të Fakultetit të Arteve të Bukura, për vitin akademik 2017-2018”, pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të 2 studentëve (Erolda Cela dhe Vashë Musa) të Fakultetit të Arteve të Bukura, të cilët bazuar nga proces verbalit i Grupit të Punës me nr. 340/1 prot. datë 21.05.2018 kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar në lidhje me ekzaminimin e sëmundjes së tyre nga komisioni mjeko ligjor (bashklidhur vendimit).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Drejtoria Ekonomike.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI ADMINISTRIMIT

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Elira KOKONA (Kryetar)

Prof. Artan PEQINI (Anëtar)

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Prof. Besnik BISHA (Anëtar)

Dhimitër BAKO (Anëtar)

Arjan KONOMI (Anëtar)

Erjon NDROQI (Anëtar)